RREGULLORE E PERDORIMIT TE LOGOS, CERTIFIKATAVE DHE RAPOTEVE TE TESTIMIT DHE INSPEKTIMIT

TITULLI I DOKUMENTIT	RREGULLORE E PERDORIMIT TE LOGOS, CERTIFIKATES DHE RAPORTEVE TESTIMIT DHE INSPEKTIMIT
KODI	**RR-AQS-002.**
RISHIKIMI	06
DATA	**20/01/2026**

Hartimi	Kontrolli	Aprovimi

1 QELLIMI DHE FUSHA E ZBATIMIT

Kjo rregullore ofron rregullat per Organizmin te cilit i eshte leshuar certifikata/ raporti/kuialifikimi mbi menyren e publikimit te saj me qellim te sigurojne nje shperndarje te drejte te imazhit te Organizmit apo personit te pajisjur me nje Certifikate apo Raport dhe AQSCERT. Qëllimi është të sigurohet një komunikim korrekt, i paanshëm dhe i kontrolluar i imazhit të laboratorit dhe të AQSCERT SHPK, duke shmangur çdo keqinterpretim ose përdorim të gabuar që mund të ndikojë tek palët e interesuara.

2 STANDARTET REFERUES

- Manuali i Cilesise AQSCERT SHPK, varianti ne fuqi.
- EN ISO/IEC 17021 “Kerkesat per Organizmat qe ofrojne certifikim” varianti aktual.
- EN ISO/IEC 17025 “Kerkesat per laboratoret testues” varianti aktual.
- EN ISO/IEC 17020 “Kerkesat per Organizmat qe ofrojne inspektim” varianti aktual.
- EN ISO/IEC 17024 “Kerkesat per Organizmat qe ofrojne certifikimin e personelit”
- DA-PM-004 “Rregulli per perdorimin e logos se akreditimit” varianti aktual.

3 TERMA DHE PERKUFIZIME

Termat dhe perkufizimet jane te pershkruara ne EN ISO 9000:2015 .

Rregulloret e Entit të Akreditimit, publikimet IAF dhe ILAC-MRA.

4 KUSHTET PER PERDORIMIN E LOGOS, CERTIFIKATES DHE KONTROLLET RELATIVE

4.1 PERDORIMI I SIMBOLIT, LOGOS

SIMBOLI, element identifikues dhe i vecante i AQSCERT SHPK, perben logon e Entit qe perdoret nga vet AQSCERT SHPK si dhe nga Organizmat kliente per te bere publicitetin e te qenurit te Certifikuar/inspektuar. Kjo shenje dalluese eshte prone ekskluzivisht vetem e AQSCERT SHPK.
Simboli eshte e formuar sipa fig 1:

Fig 1.

SIMBOLI, LOGO e AQSCERT SHPK e derguar ne menyre elektronike te njesuar me Certifikaten e Konformitetit, mund te perdoret nga Organizmat e Inspektuar vetem nen mbikqyrjen e kesaj rregullore.

<u>Perdorimet e lejuara</u>

Klientet mund te riprodhojne Simbolin e AQSCERT SHPK (duke respektuar plotesisht mostren e pershkruar), ne korrespondencen mes tyre, ne kartatvizita, ne publicitetet e ndryshme, ne artikujt promovues, ne sitet e Web, ne mallrat apo mjetet e perdorura per realizimin e proceseve raportuese ne fushen e inspektuar(mjetet tregtare, rroba pune, etj.) Fig 2.
Eshte e mundur te zmadhosh ose te zvogelosh marken ne permasa te njejta duke mbajtur parasysh proporcionet, ngjyrat origjinale (per nevoja te riprodhimit pranohen ndryshime te lehta ne tonalitet e ngjyrave baze te simbolit), ose ne bardhe e zi, me kusht qe gjithsesi te mbetet qartesisht e lexueshme sic pershkruhet ne Fig 2.

Fig 2

perdorimi i logos ne versionin origjinal

perdorimi i logos ne versionin me ngjyre te zeze.

Perdorimi i logos ne sfond te erret

Distancat e vendosjes se logos me element te tjere te dokumentit, simboleve te tjera .



PERDORIM I PAPRANUESHEM/LIMITIME.

Nuk lejohet riprodhimi i SIMBOLIT se AQSCERT SHPK mbi objektet te ndryshme qe konfigurohen si produkte objekt i certifikimit/inspektimit/ raporte testimi/ certifikata trajnimi vecanarish nese eshte e aspekteve te detyrueshme ose te percaktuara nga rregullore,(makineri, pajisje, ..etj.) dhe per cdo nevoje per dokumentacionet teknike konform produkteve te realizuara psh Organizmat ne te cilat produkti eshte nje dokument (inspektim) apo profesionet intelektuale (inxhiniere, konsulente, laboratore) nuk mund te aplikojne logon ne dokumentat e tyre).

Duhet te evitohet qe raportet/certifikatat e certifikimit/inspektimit te leshuar nga AQSCERT SHPK , te krijoje konfusion dhe te nenkuptoje nje “certifikim/inspektim produkti”;dhe per te evituar nje mundesi te tille, eshte e ndaluar qe nje Organizem te riprodhoje marken mbi produktet , mbi ambalazhimet ose mbi artikujt “kryesore” te prodhuar (ambalazh i projektuar per te mbajtur produktin dhe qe perben nje njesi shitje te destinuar per konsumatoret apo perdoruesit final).

Eshte e lejueshme perdorimi i SIMBOLIT vetem mbi ambalazhimet “dytesore” (ambalazh i projektuar per rigrupimin e ambalazheve kryesore dhe qe perdoret vetem per te mbrojtur keto dhe per te lehtesuar levizjet dhe perdorimin), me kusht qe te respektohen te njejtat kushte te aplikuara mbi simbolin e inspektimit te percaktuara ne kete rregullore.

IMPENJIMI PER PERDORIMIN E SIMBOLIT “AQSCERT SHPK”

Shoqeria duhet te garantoje se:

- Te mos mbaje marken e AQSCERT SHPK, pa formulimin e saj (AQSCERT SHPK) te pershkruar me lart;[1]
- Shkrimet per formulimin e lartpermendur te mos kene permasa me te medha nga ata te perdorur per emrin e shoqerise.
- Te jene respektuar perqindjet e origjinalitetit te SIMBOLIT dhe qe ato te jene ne permasat maksimiuni prej 25 mm te gjera (ku SIMBOLI te jete vendosur ne dokumentat e perdorur nga shoqeria);
- Duhet te kete deklaruar qe eshte inspektuar, sipas standartit referues ne certifikate.

- Nuk duhet te vendoset SIMBOLI i AQSCERT SHPK ne raportet e provave, inspektimit te leshuara nga AQSCERT SHPK
- **Do te perdoret SIMBOLI i AQSCERT SHPK vetem per aktivitetet e inspektimit dhe te vendeve (zyra, ambjenteve,adresave) qe lidhen me aktivitetin e inspektimit.** Organizmat qe disponojne zyra/filiale/ ndertesa te painspektuara ose me aktivitet qe nuk perfshihet ne sistemin e manaxhimit (pra te pa pershkruar ne certifikate), mund te perdorin marken **me kusht qe te evidentohen limitet e tyre** , ne menyre qe te bejne te kuptohet kush jane aktivitetet/ zyrat/filialet e inspektuara dhe kush jane te painspektuara;
- Zgjidhje te ndryshme nga ato te percaktuara ne kete pike, jane zgjidhje paraprakisht te autorizuara me shkrim nga AQSCERT SHPK.

4.1.1 Perdorimi i simbolit, logos bashkuar me simbolin e DPA

Eshte i drejte perdorimi i Simbolit te entit te Akreditimit tek certifikatat e Organizmave te certifikuar/Inspektuar/raportet e testimit nga AQSCERT SHPK vetem ne sektoret e akredituar .

DETYRIMET PER PERDORIMIN E SIMBOLEVE "AQSCERT SHPK"/Ent Akreditimi

AQSCERT SHPK duhet te garantoje qe:

- AQSCERT SHPK perdor logon e entit te akreditimit vetem per fushat ne te cilat eshte akredituar
- AQSCERT SHPK mund te perdore logon e akreditimit vetem ne certifikatat e leshuara prej saj te cilat kane fusha te akredituara.
- AQSCERT SHPK mund te perdore logon e akreditimit, per rastet promovuese, vetem nese promovohet aktiviteti per te cilen eshte akredituar.
- Do te jene rreptesisht te respektuara ne te gjitha rastet rregullat e pershkruara ne rregulloret e entit te akreditimit.
- AQSCERT SHPK mund te beje reference tek statusi EA-MLA vetem per fushat ne te cilat DPA eshte firmetare e marrveshjes te njohjes me EA.
- Perdorimi grafik do te jete si ne fig e meposhtme.

Fig 1

MENAGMENT SYSTEM CERTIFICATION
S SH EN ISO/IEC 17021-1
CS 008

Fig 2

MENAGMENT SYSTEM CERTIFICATION
S SH EN ISO/IEC 17021-1
CS 008

Fig 3

Testim
S SH EN ISO/IEC 17025
LT 121

Fig 4

Certifikim personi
S SH EN ISO/IEC 17024
CN 017

Ne vecanti dy simbolet (Ent akreditimi dhe AQSCERT SHPK duhet te jene te pozicionuara ne afersi te njera tjetres.
Ne perberjet grafike, respektohen proporcionet te percaktuara ne dimensionet e referimit. Ne cdo rast , permasat e Simbolit se akreditimit (horizontalisht dhe vertikalisht) nuk duhet te rezultojne asnjehere me te medha se permasat korresponduese te simbolit AQSCERT SHPK. Per perdorimin me karakter dokumentar, simboli mund te zvogelohen, duke respektuar nevojen per lexueshmeri dhe duke mbajtur raportin e dimensioneve te lartpermendura. Parimisht, per gjera te permasave te medha, dy simbolet e nderthurura mund te jene zmadhuar , gjithmone duke mbajtur raportin e dimensioneve te lartpermendura. Ne alternative me perberjen grafike te fig 1 eshte i zbatueshem versioni i thjeshtuar me shkrimin “Organizem i akredituar nga enti i akreditimit”; permasat e shkrimit nuk duhet t`i kalojne (horizontalisht dhe vertikalisht) hapesirat korresponduese te zena nga simboli OÇ sic eshte pershkruar ne **Figura 3**:
Ngjyrat baze te perdorura per simbolin e Akreditimit (perkatesisht ne shkrim – eshte sipas logos se entit te akreditimit)
Neqofte se AQSCERT SHPK -se mund t`i jete anulluar ose terhequr akreditimi, lidhur me nje skeme te percaktuar, AQSCERT SHPK do te parashikoje ne kohen e duhur te lajmeroje me shpejtesi klientet e tij me fax / e-mail per anullimin e akreditimit.
Simboli i akreditimit do të vendoset në pjesën e sipërme të raportit / certifikatës në anën e djathtë. Ky ndryshim ne formatin e certifikatave te leshuara nga AQSCERT hyne ne fuqi ne daten 01.08.2021.

4.2 PERDORIMI I CERTIFIKATES, REFERUAR CERTIFIKIMIT DHE GJENDJES SE TIJ

Shoqerite qe kane nje certifikate ne perputhje me certifikimet/Inspektimet mund:

- Te njoftojne klientet ose bleresit potenciale per pajisjen dhe kohezgjatjen e kesaj certifikate.
- Te bejne publik dokumentin e certifikimit/inspektimit duke mbajtur parasysh menyrat e parashikuara nga rregullorja.
- Ta perdorin certifikaten sipas autorizimit te marre.

Shoqerite certifikaten e tyre mund ta publikojne lirisht dhe/ose ti riprodhojne ne dimensione origjinale ose te zvogeluara, gjithmone kur mbi ato te riprodhuarat rezultatet jane lehtesisht te lexueshme.
Certifikata/raportit i inspektimit/raport testimi i leshuar nga AQSCERT SHPK jane te vlefshme sipas kerkesave ligjore.
Shoqeria mund te perdore certifikaten/raportin e inspektimit/raport testimin ne respekt me sa eshte pershkruar ne kete rregullore.

➢ ZOTIMI PER PERDORIMIN E CERTIFIKATES, REFERUAR CERTIFIKIMIT DHE GJENDJES SE TIJ.

Shoqeria duhet te garantoje qe;

- Te plotesoje kerkesat e AQSCERT SHPK per t’ju referuar gjendjes se inspektimit te saj me ane te komunikimeve si internet, materiale publiciteti ose dokumenta te tjere;
- Te mos beje, dhe te mos lejoje, deklarime qe mund te krijojne iluzione lidhur me inspektimin e saj;
- Te mos perdore, dhe te mos lejoje perdorimin, e nje dokumenti te inspektimit ose te cdo pjese te tij, ne menyre qe te krijoje iluzione dhe mashtrime;
- Te mos lejoje qe te nenkuptohet qe inspektimi aplikohet ne aktivitete qe jane jashte fushes se aplikimit te inspektimit;
- Te mos perdore certifikaten/raportin e saj ne menyre te tille qe te demtoje reputacionin e AQSCERT SHPK dhe/ose te sistemit te inspektimit dhe te kompromentoje besimin e publikut.

4.3 MBIKQYRJA MBI PERDORIMIN E SIMBOLIT, LOGOS DHE TE CERTIFIKATES

AQSCERT SHPK gjate verifikimeve te mbikqyrjes kontrollon mbi perdorimin korrekt te simbolit, logos, certifikates/raportit te inspektimit/raport testimit.

Shkelja e vetem nje prej dispozitave te lartpermendura do te trajtohet nga AQSCERT SHPK si nje kundravajtje (shkelje) e Rregullores dhe do te sanksionohet me adoptimin e masave ne baze rendesise, funksionit dhe madhesise se kundravajtjes.

4 Perdorimi i ndyshimeve te lehta pa kompremen tuar/ paragjykuar per kuptimin/besimin korrekt te inspektimit nga ana e paleve te interesuara.
Perdorimi me pasaktesi te dukshme i simbolit, certifikates/raportit te inspektimit

5 Dhenia e nje jokonformiteti te rendesishem dhe nderprerje e menjehershem e inspektimit (me kerkese te menjehrshme te veprimeve korrigjuese)

6 Mungesa ose zbatimi i papershtatshem i veprimeve korrigjuese perseritje te gabimit; Anullim dhe terheqje e certifikates se inspektimit se konformitetit, publikim i anullimit te certifikates.

7 Vazhdimesia e mosplotesimit dhe/ose perseritja e kundravajtjeve pertej kufijve te periudhes se nderprerjes dhe/ose perdorimi me qellim te keq ose mashtrues te logos ne perdorim: Veprime ligjore te parashikuara ne ligji.

Realizimi i veprimeve korrigjuese efikase brenda kohes se vendosur percakton revokimin e mases se nderprerjes se vlefshmerise se certifikates dhe raporteve te inspektimit.

4.4 NDERPRERJA E PERDORIMIT TE CERTIFIKATES, SIMBOLIT DHE PARASHIKIMET RELATIVE PER PERDORIMET ABUZUESE.

AQScert merr masa te pershtatshme per te trajtuar cdo referim jo korrekt te sistemit te certifikimit, inspektimit, testimit ose cdo abuzim me certifikatat, inspektimet, testimet dhe simbolet te nxjerra ne publicitet, ne kataloge etj.

Perdorimi i certifikates , raport testimit, raport inspektimit dhe te simbolit, nga ana e shoqerive te certifikuara, inspektuar, testuar duhet nderprere menjehere ne rastet e meposhtme:

- Nderprerja, terheqja ose anullimi i certifikates dhe raporteve te testimit dhe inspektimit.
- Kur afati i kontrates mbaron.
- Nuk pranohen nga ana e AQScert modifikimet e sjella nga shoqerite, persa i perket Sistemit te Manaxhimit, persa i perket supozimeve per te verifikuar mirembajtjen e certifikates dhe raporteve te testimit dhe inspektimit.
- Mungesa e zbatimit nga ana e shoqerive te veprimeve te pershtatshme te kerkuara nga AQScert, si rrjedhoje e modifikimeve te sjella nga vete ato ne rregullat e Sistemit te Certifikimit, inspektimit, testimit.
- Nxjerrja e “Situatave” pergjegjese per te influencuar negativisht mbi Sistemin e Manaxhimit te shoqerise se certifikuar, te formalizuara tashme shoqerise.

Ne rast te vazhdimit te keqperdorimit te certifikates apo simbolit, AQSCERT rezervon te drejten ti drejtohet Gjykates se Shkalles se Pare, Tirane, duke kerkuar demshperblim financiar, vlera e te cilit do te percaktohet nga kjo Gjykate, ne varesi te demit te shkaktuar ndaj AQSCERT.

8 DOKUMENTACIONI I PERDORUR

- Riprodhimi grafik i SIMBOLIT ne formatet .eps dhe jpg respektivisht per riprodhimet tipografike ose ne ambiente microsoft windows (ne versionin shumengjyresh per skemen e certifikimit me nderthurjen ose jo te simbolit se entit te akreditimit).

9 TE DREJTAT DHE DETYRIMET

6.1 VLERESUESIT

- Ne rrjedhen e verifikimeve te programuara rezultojne monitorimi per perdorimin korrekt te simbolit, certifikates dhe raporteve te testimit dhe inspektimit.

6.2 ORGANIZMAT E CERTIFIKUAR

- Do te bejne perdorimin e simbolit, certifikates, raporteve te testimit dhe inspektimit si dhe certifikates se konformitetit sipas asaj cfare eshte parashikuar ne kete rregullore.
- Ne rastet ku Aqscert ka leshuar certifikata ne fushat ku ajo nuk eshte akredituar, menjehere pas marrjes se akreditimit per keto fusha do te beje terheqjen e certifikatave te cilat jane pa simbolin e akreditimit dhe do ti zevendesoje ato me certifikata te reja qe permbajne simbolin e akreditimit.
- Aqscert nuk do te leshoje asnje certifikate pa simbolin e akreditimit ne fushat ne te cilat Aqscert eshte akredituar.